



## Qasja në Beneficionin e Shtuar në rast të Sëmundjes me Covid-19 dhe Pagesa e Papunësisë gjatë Pandemisë për njerëzit në Provizion Direkt

**Çdo punëtor (duke përfshirë edhe jo-shtetasit) mund të marrë Beneficionin e Shtuar në rast të Sëmundjes nga dita e parë nëse duhet të vetizohet**

### E premte, 7 gusht, 2020

Ministri i Mbrojtjes Sociale, Heather Humphreys, TD, sot ka siguruar punëtorët që janë diagnostikuar me Covid-19, ose janë çertifikuar nga një mjek për tu izoluar sepse janë një burim i mundshëm i Covid-19, që Pagesa e Beneficionit të Shtuar në rast të Sëmundjes nga Departamenti i saj është në dispozicion për ata.

Të gjithë të punësuarit (përveç disa punonjësve të sektorit publik që paguajnë një normë të modifikuar të sigurimeve shoqërore) dhe të vetëpunësuarit, **përfshirë jo-shtetasit dhe njerëzit që jetojnë në Provizion Direkt**, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin pagesën speciale të Beneficionit në rast të Sëmundjes Covid-19.

Më herët këtë javë, Ministri Humphreys siguroi miratimin e qeverisë për të zgjatur kohëzgjatjen e skemës së **Beneficionit të Shtuar në rast të Sëmundjes** deri më **31 Mars të vitit të ardhshëm**.

Për të marrë këtë pagesë, një punonjës duhet:

- Të **diagnostikohet** me një infeksion Covid-19 siç vërtetohet nga një mjek i regjistruar ose, të jetë i certifikuar nga një mjek i regjistruar për tu **vetizuar**;
- të jetë i moshës midis 18 dhe 66 vjeçare;
- të jetë i punësuar ose i vetëpunësuar dhe të ketë punuar në katër javët përpara 'datës së deklaruar të certifikuar';
- të ketë një kontratë pune (nëse është punonjës); dhe
- të ketë të paktën një kontribut të paguar të sigurimeve shoqërore në 4 javët e fundit përpara se të kërkojë pagesën.

## **Si të aplikoni:**

Mënyra më e shpejtë dhe më e lehtë për të aplikuar është në internet në [www.MyWelfare.ie](http://www.MyWelfare.ie). Formularët e aplikimit janë gjithashtu në dispozicion nga Departamenti duke na kontaktuar në (01) 704 3300.

Asnjë ditë pritjeje nuk aplikohet për kërkesat e Covid-19, që do të thotë se pagesa fillon ditën e parë që personi është çertifikuar nga mjeku si i paaftë për të shkuar në punë. Në rrethana normale, njerëzit që kërkojnë Beneficion në rast të Sëmundjes nuk paguhen për 6 ditët e para të kërkesës së tyre. Kjo kërkesë është hequr për Beneficionin e Shtuar në rast të Sëmundjes.

## **Testimi:**

Nëse mendoni se mund të keni Covid dhe duhet të telefononi mjekun tuaj - këto konsultime të lidhura me Covid-19 dhe të gjitha referimet për një test janë të përfshira nga HSE dhe janë falas. Testi është gjithashtu falas.

## **Pagesa:**

Norma e pagesës personale është €350 në javë, krahasuar me normën normale të Beneficionit të Shtuar në rast të Sëmundjes prej €203 në javë.

Beneficioni i Shtuar në rast të Sëmundjes paguhet për:

- dy javë kur një person është i çertifikuar nga mjeku për tu vetizoluar, dhe
- për një maksimum prej dhjetë javësh, kur një person është i çertifikuar nga mjeku si i diagnostikuar me Covid-19.

Ministri Humphreys komentoi:

*“Covid-19 ka sjellë shumë sfida për çdo individ, familje, shtëpi dhe vend pune në të gjithë Shtetin. Dua t'i siguroj njerëzit sot që Beneficioni i Shtuar në rast të Sëmundjes është në dispozicion për njerëzit që duhet të kërkojnë këtë pagesë. Unë veçanërisht dua të siguroj që jo-shtetasit dhe njerëzit që jetojnë në Provizion Direkt janë plotësisht të vetëdijshëm për këtë pagesë dhe mënyrën se si duhet ta kërkojnë atë.*

*“U kam kërkuar zyrtarëve të Departamentit tim të punojnë me kolegët e tyre në Departamentin e Drejtësisë për të siguruar që çdo Qendër e Provizionit Direkt të pajiset me këtë informacion dhe që ajo t'u komunikohet të gjithëve që jetojnë në qendra, pa vonesë.*

*“Kur një person ka një shqetësim, ai mund të kontaktojë direkt seksionin e Beneficionit në rast të Sëmundjes të Departamentit tim dhe të flasë me një zyrtar i cili do t'i këshillojë ata se si të kërkojnë pagesën dhe t'i përgjigjen pyetjeve që mund të kenë.*

## **Pagesa e Papunësisë gjatë Pandemisë**

Ministri gjithashtu theksoi se punonjësit që janë jo-shtetas dhe punonjësit që jetojnë në Qendrat e Provizionit Direkt gjithashtu kanë qasje, nëse pushohen nga puna përkohësisht pa pagesë, për shkak të Covid-19, të kërkojnë Pagesën speciale të Papunësisë gjatë Pandemisë dhe se kjo pagesë do të paguhet me efekt nga kur ata u pushuan përkohësisht.

*“Dua të sigurohem që të gjithë punëtorët, puna e të cilëve është pezulluar përkohësisht për shkak të mbylljes së detyruar të një biznesi si rezultat i Covid-19, mund t’i qasen mbështetjes së nevojshme të të ardhurave. Kjo përfshin punëtorët që jetojnë në Qendrat e Provizionit Direkt. Shumica e punëdhënësve do të vazhdojnë të paguajnë punëtorët në këto rrethana duke përdorur Skemën e Përkohshme të Subvencionit të Pagës, por kur një punëdhënës nuk mund të vazhdojë të paguajë drejtpërdrejt punëtorin, atëherë ai punëtor duhet të kërkojë Pagesën e Papunësisë gjatë Pandemisë.”*

Mënyra më e lehtë që njerëzit të aplikojnë për Pagesën e Papunësisë gjatë Pandemisë është online në [www.MyWelfare.ie](http://www.MyWelfare.ie). Kur aplikojnë, njerëzit duhet të japin emrin e punëdhënësit të tyre dhe detajet e ditës së fundit të punësimit.

Ministri përfundoi:

*“Mesazhi kryesor është çdo punëtor, duke përfshirë një jo-shtetasit ose një person që jeton në një Qendër të Provizionit Direkt, i cili është i certifikuar nga mjeku për të qëndruar larg punës dhe të vetizohet duhet të kërkojë Beneficionin e Shtuar në rast të Sëmundjes menjëherë dhe të qëndrojë i sigurt. Nëse biznesi i punëdhënësit të tyre mbyllet përkohësisht për shkak të Covid-19, por ata vetë nuk kërkohet të izoloohen, atëherë, nëse punëdhënësi i tyre nuk po vazhdon t’i paguajë ata, ata duhet të kërkojnë Pagesën e Papunësisë gjatë Pandemisë.”*

### **Detajet e Kontaktit të Zyrës së Shtypit**

E: [press.office@welfare.ie](mailto:press.office@welfare.ie)

T: 01 704 3082

[gov.ie/deasp](http://gov.ie/deasp) | [Twitter](https://twitter.com) | [Instagram](https://www.instagram.com) | [LinkedIn](https://www.linkedin.com)